



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:109636

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428256

P.nr.345/2007

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues -gjyqtarit Ali Kutllovci, dhe anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët Leart Rexhaj dhe Marigona Lajqi, me bashkëpunëtorin profesional Arbër Beqiri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit A.G, për shkak të veprës penale: Vrasje në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së, dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së (Kodit të përkohshëm penale të Kosovës), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.47/07 e dt.17.12.2007. Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar është tërhequr nga ndjekja penale për veprën penale nën pikën –II- të aktakuzës sepse është përfshirë në amnesti, ndërsa lidhur me veprën penale nën pikën –I- të dispozitivit e ka ricilësuar në senacën e shqyrtimit gjyqësor nga ana e prokurorit të shtetit në veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së (Kodit të përkohshëm penal të Kosovës), pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.26.02.2024, e cila ishte e hapur për publikun, në të cilin prezent ishin Prokurori i Prokurorisë Themelore Mitrovicë –Njazi Rexha, i akuzuari A.G dhe mbrojtësi i tij av.Mehdi Geci, të njëjtën ditë e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa me dt.08.03.2024, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

A.G, nga i ati J..., e ëma H..., e vajzërisë E..., ‘‘data e lindjes’’, në fsh....-Komuna e Skenderajit, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.pers...., i martuar, baba i një fëmiju, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar, ndaj tij nuk udhëhiqet procedurë penale.

Në bazë të dispozitës ligjore nga neni 362 par.1 nën par.1.1 të KPP-së:

REFUZOHET AKTAKUZA

SEPSE: Më 03.02.2007 rreth orës 12:40 min në rrugën ‘‘R... K....’’ në S..., pas një zënke rreth lirim të vendit për të dalur nga parkingu ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin Sh.B dhe e godet me thikë me teh të gjatësisë 11 cm në anën e majtë në shpinë një herë me që rast i shkakton lëndime plagë prerse në regjionin i jor (pjesa e belit) e majtë – dëmtime të lehta trupore.

Me këtë veprim kishte kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së (Kodit të përkohshëm penal të Kosovës).

-I akuzuari lirohet në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale për këtë rast.

-Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m i

Aktakuza:

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, me aktakuzën e saj PP.nr.47/07 e dt.17.12.2007 e ka akuzuar të akuzuarin A.G, për shkak të veprës penale: Vrasje në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së (Kodit të përkohshëm penal të Kosovës).

Rrjedha e procedurës:

Më 05.05.2023, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve. Në shqyrtimin fillestar prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së (Kodit të përkohshëm penal të Kosovës).

I akuzuari e ka mohuar në tërësi fajësinë për veprën penale Vrasje në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së për të cilën vazhdon procedura sipas aktakuzës ashtu që të akuzuarit i është dhënë mundësia të paraqesë kundërshtim apo kërkesë për hudhje të aktakuzës brenda afatit të përcaktuar dhe duke u mbështetur në nenin 240 paragrafi 7 të KPP-së, brenda këtij afati mbrojtësi dhe i akuzuari kanë parashtruar kërkesë për hudhje të aktakuzës.

Gjykata me aktvendimin P.nr.345/07, të dt.20.09.2023, e ka aprovuar kundërshtimin e mbrojtësit dhe kërkesën për hudhjen e aktakuzës ashtu që Gjykata e ka hudhur aktakuzën.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë Prokurori i shtetit. Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendim PN.nr.1233/23 dt.10.11.2023 e aprovon pjesërisht ankesën e prokurorit të shtetit dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë pjesërisht e anulon për pikën –II- të dispozitivit gjegjësisht për veprën penale Vrasje në tentativë, nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPPK-së dhe çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale është mbajtur më dt.12.12.2023, kjo seancë ka qenë e hapur për publikun në të cilën janë proceduar i dëmtuari Sh.B.

Me dt. 26.02.2024 është mbajtur seanca e radhës në të cilën janë proceduar dëshmitarët E.H, E.M, janë administruar provat materiale, është marrë në pyetje i akuzuari dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve. Shpallja publike e aktgjykimit është bërë në të njëjtën ditë, pra me dt.26.02.2024, në mungesë të palëve.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar: Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor nga deklaratat e dëshmitarëve E.M dhe E.H rezultoi se asnjëri prej tyre nuk e kanë parë momentin kur është goditur me thikë i dëmtuari Sh.B dhe nuk dinë se kush e ka goditur të dëmtuarin, po ashtu nga deklarimi i të dëmtuarit në polici rezulton se i njëjti nuk ka deklaruar të vërtetën kur potencon se është goditur tri herë me thik nga i pandehuri A.G, e cila deklaratë është në kundërshtim me deklaratën e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me dt.12.12.2023 kur deklaroi se nga A.G është goditur vetëm një herë, në spital ka qëndru vetëm deri sa i është bërë ekzaminimi dhe e ka marrë dokumentacionin mjekësor. Nga raporti mjeko ligjor i dt.12.12.2023 rezulton se dokumentacionit të QKMF-së, në Skenderaj, viktimja Sh.B ka dy plagë, ndërsa nga fletëlëshimi me epikriz lëshuar në QKUK-Klinika e Kirurgjis, theksohet se kemi të bëjmë me një plagë. Këtë mendim e ka dhënë komisioni mjekësor e që e konfirmon vetëm një plagë e të cilën e konfirmon edhe vet i dëmtuari në shqyrtim gjyqësor dhe mbi këtë bazë e bëjë edhe ndryshimin e dispozitivit të aktakuzës siq është përshkruar tani në dispozitivin e aktgjykimit dhe heqet fjalia Vrasje në tentativ nga neni 146 lidhur me nenin 201 të KPP-së e duhet të jetë Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Bazuar në këto rrethana prokurori deklaroi se vepra penale Lëndim i lehtë trupor, është paraparë dënimi me burgim deri në tri vite e që në rastin konkret rezulton se vepra penale është kryer me

dt.03.02.2007, cka nënkupton se ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale, andaj mbi këtë bazë tërhiqem nga aktakuza.

Pas tërheqjes nga aktakuza nga prokurori i shtetit, gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 362 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, ka marrë aktgjykim me të cilin e ka refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.47/07 të dt.17.12.2007, të ri cilësuar në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor nga prokurori i shtetit, duke e akuzuar të akuzuarin A.G, për veprën penale: Lëndim i lehtë truporë, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 të KPPK-së, e për të cilën ka arritur parashkrimi absolut.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Palën e dëmtuar për kërkesën pasurore juridike, gjykata e udhëzoi në kontest civil duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 462 par.3 të KPP-së.

Ngase u tha me lartë e bazuar në nenin 362 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, u vendos në dispozitiv të këtij të aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.345/2007, dt.08.03.2024

Bashkëpunëtori Profesional

Arbër Beqiri

Kryetari i trupit gjyqësor

Ali Kutllovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 30 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.